



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 42 datë 26.10.2023

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANFERIMIN NË PRONËSI TË PRONËS “AGJENCIA RRENC“ ME NR PASURIE 19/2, ZK 3168, INDEKS HARTE K-34-64-(210-B) , ME SIPERFAQE PREJ 31,165.2 m², NGA MINISTERIA E MBROJTJES TEK BASHKIA SHKODËR ”.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 3 germa k), nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, date 22.02.2001 “Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, date 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per transferimin ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike”, pas shqyrtimit të relacionit të administratës së bashkisë Shkodër ;

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të bashkisë Shkodër të pronës me të dhëna:
 - “Agjencia Rrenc” (Shtabi i Brigadës së Artilerisë, Ish rep.usht.nr.1190” Rrenc, Shkodër nr.426) me nr. pasurie 19/2, ZK 3168, Indeks i Hartës K-34-64-(210-B), me siperfaqe prej 31,165.2 m², në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, referuar dokumentacionit tekniko-ligjor bashkëlidhur.

2. Fusha e përdorimit të kësaj pasurie do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.
3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë dhe fushës së përdorimit të pasurisë së sipërcituar, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Mbrojtjes.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Oltion LUMI



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 44 vota

Vota Pro 44

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.10.2023